



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Datë: 19.11.2013

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.21/2012 për avancim në karrierë të nëpunësve civil, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), shpall këtë:

KONKURS I BRËNDSHEM
për
Avancim në karrierë

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar i lartë i përkthimeve
Kategoria dhe grada:	Nivel profesional, koeficienti 7.5
Nr. i referencës:	AKSP-5/2013
Raporton të:	Udhëheqësi i DPGJ-së

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

1. Ndhmon udhëheqësin që të mbikëqyrë, menaxhoj dhe koordinoj punët brenda Divizionit për Përkrahje Gjuhësore për të gjitha çështjet që kane të bëjnë me përkrahje gjuhësore në AKSP.
2. Ndhmon udhëheqësin në përgatitjen dhe prezantimin e politikave të Divizionit dhe i dorëzon raportet për planifikimet javore, mujore dhe vjetore kur të kërkohet nga ana e Udhëheqësit të Divizionit të Përkrahjes Gjuhësore.
3. Ndhmon udhëheqësin në identifikimin, sigurimin dhe menaxhimin e burimeve të nevojshme për të siguruar që të gjitha aktivitetet e Divizionit të realizohen në mënyrë efektive dhe efikase në të gjitha aspektet.
4. Ndhmon udhëheqësin në përkrahjen e AKSP-se me qëllime të zhvillimit dhe mbështetjes së programeve trajnuese duke ofruar përkrahje gjuhësore.

5. Ndhmon udhëheqësin ne sigurimin që i tërë stafi të jetë i njoftuar me kohë për detyra dhe të asistojë në menaxhimin e punës që identifikon mungesat që pastaj mund të adresohen.
6. Ndhmon udhëheqësin në bashkërendimin dhe ndërlidhjen e punëve sipas nevojave të njësive tjera organizative brenda AKSP-së.
7. Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së Udhëheqësit të Divizionit të Përkrahjes Gjuhësore.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohet për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit

Për pozitën, Zyrtar i lartë i përkthimeve, **procedura e konkurimit është e brendshme (vetëm për nëpunësit civil ekzistues të akademisë).**

Shkollimi i kërkuar

- Përgatitje Universitare në lëmine e gjuhës dhe letërsisë (e obligueshme).

Aftësia, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

Njohuri të mira të punës me kompjuter, me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point). Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor, nën presion të punës dhe brenda afateve të kufizuara kohore. Aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike, duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin. Vetiniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor. Së paku një (1) vite përvojë pune në fushën përkatëse (e nevojshme). Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme). Njohja e gjuhës angleze (e obligueshme).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

Përzgjedhja e Zyrtarit të lartë të përkthimeve, bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.21/2012 për avancim në karrierë të nëpunësve civil, Rregulloren Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr.07/2010 për emërimin e nëpunësve civil.

Kohëzgjatja e emërimit

Për pozitën, Zyrtar i lartë i përkthimeve, emërimi është me kohë të pacaktuar (karrierës).

Data e mbylljes se konkursit

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 19.11.2013 deri me datën 26.11.2013.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, Zyra e Personelit, dhoma nr.1. kati I, Ndërtesa e re administrative, ose nëpërmjet adresës elektronike: rekrutimi.aksp@rks-gov.net. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurroni.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit në numrin e tel: 028 570 008 Ext 114 ose 233, prej orës 08:00 - 1600.